



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 (paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 23.09.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-2433/13, për z. Fatmir Kadiri – Anëtar në Kuvendin e Komunës së Rahovecit, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nr. AKK – 03-2433/13, për Zyrtarin e Lartë z. Fatmir Kadiri – Anëtar në Kuvendin e Komunës së Rahovecit dhe njëkohësisht bashkëpronar në N.P.T.SH “HIT 3” Sh.p.k., është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Në rastin e lartpërmendur, zyrtari i lartë z. Kadiri është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (me datë 21.08.2013), pas së cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë. Me këtë rast ai është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet të cilat duhet të bëj për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Kadiri, në këtë takim ka deklaruar se brenda afatit ligjor do të heq dorë nga të genurit bashkëpronar në biznesin privat dhe do të vazhdoj të ushtroj funksionin e tij publik.

Mirëpo, z. Kadiri, ndërkohë ka dërguar në Agjenci informacionin zyrtar të lëshuar nga Kuvendi Komunal i Rahovecit (DPKI 03-2676/13) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka ofruar dorëheqje të parevokueshme nga posti i anëtarit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit, për të ushtruar veprimtarinë e tij private, me çka ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

